VENDIM
Nr. 13, datë 20.2.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 20.12.2016 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 78/16 Akti që i përket:

KËRKUES: Kosta Pjero, Robert Pjero.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2015-3429 (390), datë 10.6.2015 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 43, 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesve, që kërkuan pranimin e kërkesës, dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i interesuar, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesit janë në lidhje gjinie me njëri-tjetrin (kushërinj të parë) dhe respektivisht trashëgimtarë ligjorë të baballarëve të tyre V.P. dhe M.P. (vëllezër). Sipas kërkuesve, prindërit e tyre kanë qenë pronarë të një banesë dhe një sipërfaqe trualli të ndodhur në Vlorë. Pas çeljes së trashëgimisë ligjore kërkuesit i janë drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë (në vijim “*ZVRPP-ja Vlorë*”) me kërkesë për regjistrimin e sipërfaqes 1000 m^2 dhe të ndërtesës me sipërfaqe 289 m^2.

2. Subjekti i interesuar, ZVRPP-ja Vlorë, me urdhrin nr. 112, datë 7.6.2010, ka refuzuar të regjistrojë pasuritë dhe të lëshojë certifikatë pronësie për pasuritë e kërkuesve. Urdhri i ZRPP-së Vlorë është lënë në fuqi edhe nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë (në vijim “*ZQRPP-ja Tiranë*”) me urdhrin nr. 990, datë 5.7.2010.

3. Kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesëpadi me objekt shfuqizimin e akteve administrative nr. 112, datë 7.6.2010 dhe nr. 990, datë 5.7.2010 të lëshuara respektivisht nga ZVRPP-ja Vlorë dhe ZQRPP-ja Tiranë dhe detyrimin e palës së paditur të bëjë regjistrimin e ndërtesës dhe të truallit funksional.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1815, datë 6.10.2011, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, shfuqizimin e akteve administrative dhe detyrimin e palës së paditur të bëjë regjistrimin e ndërtesës dhe të truallit funksional sipas aktekspertimit topografik të kryer gjatë shqyrtimit të çështjes.

5. Kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur ankim ZVRPP-ja Vlorë dhe Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 714, datë 28.6.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim rekursin e ZRPP-së Vlorë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2015-3429 (390), datë 10.6.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimeve nr. 1815, datë 6.10.2011 dhe nr. 714, datë 28.6.2012, si dhe rrëzimin e padisë.

II

7. ***Kërkuesit*** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 28.7.2016 duke pretenduar se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është marrë në kundërshtim me standardet e procesit të rregullt ligjor. Në mënyrë të përmbledhur ata parashtrojnë se është cenuar:

7.1 *E drejta për t'u dëgjuar dhe kontradiktoriteti* gjatë gjykimit të çështjes nga Kolegji Administrativ në dhomën e këshillimit, pasi nuk janë marrë masa për njoftimin e kërkuesve për datën e seancës, me qëllim që ata të merrnin pjesë në proces dhe të parashtronin prapësimet e tyre edhe mbi bazën e dokumenteve.

7.2 *Parimi i gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Kolegji Administrativ edhe pse arsyeton në vendim se "*paditësit duhet të orientoheshin të zhvillonin proces civil për detyrim njohje pronar mbi sipërfaqet e truallit dhe ndërtesat e poseduar prej tyre*", jo vetëm nuk e ktheu çështjen për rishqyrtim, por vendosi rrëzimin e padisë. Për më tepër, parashikimi për paraqitjen e planvendosjes parashikohej nga dekreti nr. 5747, datë 21.1.1983, ndërkohë që leja e ndërtimit të kërkuesve është e vitit 1970.

7.3 Kolegji Administrativ ndonëse shprehet në dispozitiv për "ndryshim vendimi", duke iu referuar nenit 63 të ligjit nr. 49/2012, *de facto* i ka prishur vendimet dhe ka rrëzuar padinë duke shqyrtuar themelin e çështjes, në tejkalim të kompetencave kushtetuese rishikuese të parashikuara në nenin 141 të Kushtetutës.

8. ***Subjektet e interesuara, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë***, nuk kanë parashtruar prapësime me shkrim, por kanë depozituar kopje të dokumentacionit bazë të regjistrimit të pasurisë objekt gjykimi.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

9. Kërkuesit legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134 të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", i ndryshuar.

10. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata rithekson se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 31, datë 5.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Bazuar në jurisprudencën kushtetuese, Gjykata Kushtetuese ndërhyn në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve dhe të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 16, datë 19.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimet nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se kërkuesit nuk kanë në dispozicion mjet tjetër për të kundërshtuar vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye ata legjitimohen t'i

drejtohet me kërkesë kësaj Gjykate, pasi edhe pretendimet e tyre *prima facie* bien në fushën e veprimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Në këtë kuptim, ato do të shqyrtohen në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar

13. Kërkuesit kanë pretenduar se shqyrtimi i çështjes nga Kolegji Administrativ në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve dhe pa u dëgjuar, u ka mohuar të drejtën për të mbrojtur pretendimet e tyre.

14. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimin nr. 31, datë 26.5.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe, më pas, gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto parime, Gjykatës së Lartë i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata vëren se ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikon, mes të tjerash, edhe procedurën e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative. Sipas nenit 59 të ligjit, pala kundër të cilës është bërë rekurs mund të kundërshtojë pretendimet e ngritura në rekurs brenda 15 ditëve nga komunikimi i rekursit dhe mosparaqitja e kundërrekursit brenda këtij afati sjell humbjen e së drejtës për të paraqitur pretendimet në një fazë të mëvonshme në Gjykatën e Lartë. Dërgimi i dosjes në Gjykatën e Lartë bëhet brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të komunikimeve të rekursit e kundërrekursit palëve ndërgjyqëse në proces (neni 60). Për sa i përket shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, neni 61 i ligjit parashikon se ai bëhet, si rregull, mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi. Për efekt të gjykimit gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve dhe sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 21 ditë përpara. Po ashtu, ligji ka parashikuar edhe rastet kur çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore me praninë e palëve (neni 62).

17. Në rastin në shqyrtim, nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për efekte të gjykimit, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekursin e subjektit të interesuar, ZRPP-ja Vlorë, i paraqitur në datën 10.10.2012 (nr. 7022 prot). Kërkuesit kanë marrë dijeni personalisht për rekursin në datën 22.10.2012 (data e vulës postare). Me vendimin e datës 19.5.2015, gjyqtari relator i çështjes ka vendosur shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi në datën 10.6.2015, duke urdhëruar sekretarinë të bëjë njoftimin e palëve për orën dhe datën e caktuar. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 10.6.2015 rezulton se Kolegji Administrativ ka vlerësuar se palët kanë marrë dijeni rregullisht sipas ligjit dhe ka marrë në shqyrtim vetëm shkaqet e ngritura në rekurs nga subjekti i interesuar ZRPP-ja Vlorë, ndërkohë që nuk rezulton që kërkuesi të ketë paraqitur kundërrekurs ose

parashtrime me shkrim ndaj pretendimeve të palës tjetër. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore rezulton se "*palët ndërgjyqëse në proces kanë dijeni rregullisht sipas ligjit me shpalljen publike të datës 19.5.2015*". Në përfundim të procesit Kolegji Administrativ ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1815, datë 6.10.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe vendimit nr. 714, datë 28.6.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë, si dhe rrëzimin e padisë.

18. Gjykata rithekson se ligji nr. 49/2012 u garanton palëve në procesin administrativ të drejtën që jo vetëm të njihen në kohë me pretendimet e palës tjetër, por edhe t'i kundërshtojnë ato apo të paraqesin argumentet e tyre për çështjen. Shqyrtimi i rekursit në dhomën e këshillimit, sipas nenit 480 të KPC-së, si fazë paraprake ku vlerësohet plotësimi i kritereve për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore dallon nga shqyrtimi i çështjeve në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh sipas ligjit nr. 49/2012 për gjykimin e çështjeve administrative. Megjithëse në shqyrtimin e çështjeve administrative Gjykata, përgjithësisht, procedon me shqyrtimin jo në seancë publike me praninë e palëve, por në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumenteve të paraqitura, kjo nuk nënkupton se ky lloj gjykimi përjashton detyrimin për njoftimin e rregullt të palëve në mënyrë që të mbrohen në procesin gjyqësor ku janë palë me anë të paraqitjes së komenteve apo prapësimeve lidhur me pretendimet e palës që ka vënë në lëvizje gjykatën. Qëllimi i ligjvënësit në krijimin e gjykatave administrative ka qenë thjeshtimi i procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, por duke garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme (*shih vendimin nr. 76, datë 16.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata në raste të ngjashme ka vlerësuar se Gjykata e Lartë, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike apo mbi bazë dokumentesh, ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 29, datë 19.5.2016; nr. 21, datë 4.4.2016; nr. 65, datë 7.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuadër të garantimit të procesit të rregullt gjyqësor, Gjykata e Lartë ka detyrë të marrë masat për njoftimin e rregullt të subjekteve që potencialisht mund të preken nga procesi, në mënyrë që debati gjyqësor të zhvillohet në respektim të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit (*shih vendimin nr. 21, datë 4.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se Kolegji Administrativ duke mos marrë masat e nevojshme për t'u garantuar kërkuesve të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur nëpërmjet dhënies së mundësisë së paraqitjes së prapësimeve të tyre, nuk ka respektuar të drejtën e tyre për një proces të rregullt ligjor në drejtim të respektimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim.

21. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve është i bazuar.

C. Për pretendimin për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj

22. Kërkuesit kanë pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka tejkaluar kufijtë e shqyrtimit të çështjes, pasi duke e zgjidhur çështjen në themel ajo ka funksionuar si gjykatë fakti, duke pranuar rrethana të ndryshme nga ato të provuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykata e Apelit Vlorë në lidhje me origjinën e pronësisë së ndërtesave dhe të truallit funksional.

23. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga *një gjykatë e caktuar me ligj*. Ky element karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimin nr. 2, datë 22.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Për gjykimin që zhvillohet në Gjykatën e Lartë jurisprudenca kushtetuese në mënyrë të vazhdueshme ka vlerësuar se ai lidhet me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të marra nga gjykatat më të ulëta, ndërsa nxjerrja e konkluzionit mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave, nga vlerësimi i dy gjykatave të shkallëve më të ulëta, nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Lartë

nuk e ka kompetencën të konkludojë për provat, duke u nisur nga një tjetër vlerësim që kanë bërë gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit. Gjatë shqyrtimit të çështjeve ajo nuk merr prova, por shqyrton dhe analizon çështjen në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë dhe të bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara. Një kontroll i tillë konsiston në analizën e plotë të fakteve dhe të rrethanave, të cilat janë pranuar më parë si të vërteta nga gjykata e faktit dhe ajo e apelit, pa i ndryshuar ato (*shih vendimet nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 21, datë 4.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar gjatë gjykimin në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi për themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimet nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 21, datë 4.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Sipas jurisprudencës kushtetuese, Gjykata e Lartë jo vetëm nuk ka kompetencën të administrojë prova të reja, por as të anashkalojë ekzistencën e fakteve dhe të rrethanave që janë vërtetuar në gjykimin e faktit, t'i ndryshojë ato ose të arrijë në konkluzione për faktet e çështjes që bien në kundërshtim me përfundimet e gjykatave më të ulëta (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rast se Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, pasi një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit (*shih vendimin nr. 32, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton se objekti i gjykimit në themel ka qenë shfuqizimi i akteve administrative të lëshuara nga ZVRPP-ja Vlorë dhe ZRPP-ja Tiranë, si dhe detyrimi i këtyre të fundit të regjistrojnë ndërtesën dhe truallin funksional të pretenduar nga kërkuesit.

28. Nga analiza e vendimeve gjyqësore rezulton se gjykatat e faktit e kanë pranuar padinë e ngritur nga kërkuesit, duke arsyetuar se *"... palët kanë plotësisht të provuar origjinën e pronësisë dhe regjistrimin në regjistrat e vjetër të pronësisë. Kjo provohet me vërtetimin nr. 3.10.1980 lëshuar nga hipoteka Vlorë, me anë të të cilit vërtetohet se pasuria e Vasil dhe Vangjel Pjero, e regjistruar në regjistrat e inskriptimeve vol.5, nene 81 e 82, viti 1956... ka qenë e hipotekuar në favor të Bankës së Shqipërisë deri në vitin 1964, kohë kur u shlye kredia bankare dhe aktualisht prona është e lirë nga çdo barrë."*. Në lidhje me pretendimin e palës së paditur për mungesën e planimetrisë, Gjykata Rrethit Gjyqësor Vlorë ka arsyetuar se *"referuar dekretit nr. 5747, datë 29.6.1978 "Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve dhe fshatrave" i ndryshuar, në nenet 8 e 9 parashikonte që ndërtimet e reja për shtëpi banimi brenda vijave kufizuese të ndërtimit në qytet lejoheshin pasi të ishin përgatitur projekti përkatës nga zyra e urbanistikës.*". Për sa i takon aktit të ekspertimit, Gjykata e Apelit Vlorë argumenton se *"konstatimi i ekspertes se trualli që kërkohet të regjistrohet në emër të paditësve është i regjistruar në bashkëpronësi të personave të tjerë del jashtë objektit të gjykimit, pasi nuk ka lidhje me shkakun e refuzimit të kërkesës së të paditurve për regjistrim të pasurisë, që siç u theksua mbështetet në mungesën e dokumentacionit provues, por jo në mbivendosje të kësaj pasurie me pasuri të regjistruara më parë në favor të personave të tjerë...*".

29. Në ndryshim nga përfundimet e arritura nga gjykatat e faktit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar: "*Urdhri nr. 990, datë 5.7.2010 i ZRPP-së Tiranë është i drejtë dhe në konformitet me dispozitat ligjore dhe nënligjore. Në dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesit nuk rezulton të jetë paraqitur akti që përbën titull të detyrueshëm për regjistrim, për të vërtetuar pronësinë mbi pasurinë në fjalë sipas përcaktimeve të nenit 24/a të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, të ndryshuar dhe nenit 194 të Kodit Civil. Gjithashtu nuk rezulton të jetë administruar asnjë akt ligjor, i cili të vërtetojë apo të bëjë të mundur vërtetimin e ekzistencës së ndonjë transaksioni të pasurisë së regjistruar në regjistrat e inskriptimeve nr. 81 e 82, viti 1956 në favor të Kosta Pjero, i cili pretendon pronësinë mbi këtë pasuri. Leja e meremetimit nr. 17, datë 6.5.1970 lëshuar në favor të Vasil Pjero nuk rezulton të jetë e shoqëruar nga planvendosja përkatëse e miratuar nga organi shtetëror kompetent. Në asnjë moment gjatë gjykimit nuk është provuar origjina e pronës së trashëgimlënësve të paditësve.*

Trualli i pretenduar është në pronësi të familjes Sharra, i kthyer në natyrë me vendim të KKKP-së, pra një regjistrim i tillë do të krijonte mbivendosje me një pasuri të regjistruar më parë dhe ndodhur në këto kushte duhet të orientoheshin paditësit të zhvillonin një proces civil "detyrim për njohje pronarë mbi sipërfaqen e truallit dhe ndërtesa e poseduara prej tyre".

30. Bazuar në standardet e mësipërme dhe rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se Kolegji Administrativ, në kushtet e arritjes së një përfundimi të ndryshëm nga gjykatat më të ulëta, bazuar në përcaktimet e nenit 63 të ligjit nr. 49/2012, duhet t'i prishte të dyja vendimet gjyqësore dhe ta kthente për rigjykim çështjen. Gjykata rithekson se në asnjë rast Kolegji Administrativ nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel, duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykata e Apelit Vlorë.

31. Në përfundim, Gjykata vlerëson se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vepruar tej kompetencave të tij ligjore, duke cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, si një nga elementet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-3429(390), datë 10.6.2015 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Fatos Lulo,

Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj